

Mborja: Këshillë Agronit, midis luanit dhe lepurushit zgjidh të dytin

October 3, 2019 13:31



Ambjentimi me këtë “prostitucion intelektual” të shtrirë në në çdo cep të mjediseve tona akademike, është, fillim – mbarim, ajo që duhet goditur...

Po ta shohim të veçuar skandalin Tufa, do të gabonim shumë. Bash për këtë, në denoncimet e mia publike jam munduar të shmang episodet groteske që përfshijnë këtë skandal, – thotë Ilir Mborja, denoncuesi i plagjiaturës dhe falsifikimeve të drejtorit të ISKPK, Agron Tufa.

“A e mbani mend festën që keni bërë për reformën e arsimit të lartë, zoti kryeministër? A ju kujtohet se çfarë na premtuat? – pyet ai dhe shton:

“Shikoni tani se ku e keni arsimin! Tani keni një lukuni “analfabetësh modernë”, një mafie akademike që çon drejt varrit arsimin kombëtar. Nuk keni më kohë, nuk keni justifikime. Duhet tani të veproni. Përndryshe asnjë fjalë e bukur nuk do t’ju shfajësojë”.

– Zoti Mborja! Denoncimi juaj për plagjiaturën z. Agron Tufa që publikuat në faqet e gazetës sonë më 3 shtator të këtij viti riaktivizoi një polemikë që dukej se po shuhej e po ia linte radhën gjykatës, së cilës i ishte drejtuar drejtori i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit. Në mesazhin e fshehtë që ju dërgoi në WhatsApp, mes shpifjeve shantazhuese për ju, ai ju shkruan se çuditërisht në axhendën e celularit të tij gjendej numri juaj, ç’ mund të na thoni?

– Po, do t’ju tregoj për ç’ka më kërkoni, por më parë më lejoni të saktësoj diçka nga pyetja e juaj: Denoncimi im në shkrimin tim të parë, nuk kishte të bënte dhe aq me plagjiatimin e Agron Tufës ndaj Dr. Aristotel Spiros. Mbase nuk jam shprehur qartë unë atëherë, por më shumë synimi im, në frymën e studentëve që u ngritën në protesta në dhjetor, ishte të fshikulloja në stilin e një fejtani një skandal akademik për dhënien abuzivisht të gradës “Doktor” z. Tufa. Pra, me thënë të vërtetën, kur e mësova, mua më tronditi ai skandal i ndodhur në shkurt të 2008-s ku përfshihen (madje, sipas meje, edhe më të dënueshëm penalisht se përfituesi Agron Tufa) disa titullarë të profesoriatit të Filologjikut.

Tani t’i kthehemi pyetjes suaj. Për atë që z. Tufa më shkruante se në axhendën e telefonit të tij gjendej numri i telefonit tim është e vërtetë dhe më lejoni të ndalem e t’ju tregoj atë moment, jo vetëm për të shuar kureshtjen, por për t’ju folur edhe për një rastësi shumë të çuditshme dhe të rrallë nga e cila duhet të kishte nxjerrë mësim Agron Tufa. Prandaj po ndalem pak gjatë tek episodi i komunikimit tim telefonik të parë me të: Një histori përkthimi me një përkthyes gjenial si Rami Saari dhe një poezi e një poeteshe të talentuar si Luljeta Lleshanaku që drejtori i ISKPK Agron Tufa e ka vartëse, më ka detyruar të kërkoj e t’i bie telefonit të Agron Tufës... Ishte Rami Saari, njohës i mbi 15 gjuhëve e midis tyre edhe e shqipes, pra, përkthyesi i mirënjohur izraelit i cili ka përkthyer në hebraisht “Prilli i thyer”, “Piramida” dhe “Aksidenti” dhe më duhet të kujtojmë gjithashtu se, kur Ismail Kadare u nderua me çmimin e madh “Jerusalem Prize 2015”, në atë trofe është pikërisht edhe kontributi i jashtëzakonshëm i Rami Saarit. Gjej rastin t’u themi lexuesve të shumtë të gazetës “Dita” se Rami Saari, si një intelektual parimor që udhëhiqet vetëm nga e vërteta, më 16 prill të 1999-s, botoi në gazetën më të madhe të Telavivit “HA’ARETZ” dëshminë e tij në mbrojtje të kauzës së luftës për lirinë e Kosovës. Nëpërmjet një analize ekzakte, me logjikën e ftohtë që të japin faktet,

ashtu siç di vetëm ai kur futet në lëkurën e shkencëtarit, Rami Saari provoi para botës se sa e rreme ishte akuza e armiqëve të kombit tonë për gjoja “motivet islamike” të shqiptarëve të Kosovës në këtë luftë. Ai shkrim menjëherë u botua i përkthyer edhe në anglisht (“Unrepressed in Word and deed”). Shpirti i humanistit të madh nuk mund të heshte kur mbi shqiptarët binte llava e gjenocidit serbomadh. I kthjellët si kristal, me guxim dhe mençurinë e një poliglodi si ai, izraeliti i madh Rami Saari kontribuoi me atë shkrim duke demontuar një nga akuzat më djallëzore dhe të rrezikshme që armiqtë e shqiptarëve kishin fabrikuar për të disinformuar opinionin botëror.

Sigurisht, kushdo që i lexon këto radhë, kupton që nuk ka të bëjë me një njeri të zakonshëm. Madje, do të përlyej emri i këtij “hamalli” të madh të kulturës shqiptare nëse do të përpiqeshim të bënim asosacione me qëndrimin e turpshëm të Agron Tufës, që, pikërisht ato ditë kur izraeliti Rami Saari shkruante pa ia kurrkush veç ndërgjegjes së tij shkencore në mbrojtje të çështjes shqiptare, në prill të 1999-s, “intelektuali shqyptar” (siç vetëquhet nëpër komentet e tij z. Tufa) refuzoi(?!) të bënte më minimalen që i kërkonte momenti historik (nëpërmjet Ambasadorit tonë në Rusi – z. Vukaj) që të ulej e të mbronte bashkatdhetarët përballë kamerave të tv ruse... Po ato ditë të vështira për Kosovën, ishte shkencëtari ynë brilant, greko-shqiptari mendjehapur që nuk iu fsheh, por i doli përballë e i bëri ballë me mençuri e trimëri të pashoq e u mbylli gojën mes të tjerëve, edhe njëerës prej deputeteve nga më agresivet (L.Kaneli) ndaj çështjes së shqiptarëve ato ditë. Mu në Athinë, në kanalën grekë më të shikuar të Greqisë (“SKAY”), Aristotel Spiro duke theksuar se përfaqësonte veç veten e mendimin e tij personal, me ato që tha, impresionoi dukshëm shqiptarë e grekë dhe me dijet që shfaqti nderoi profesorët e universiteteve tona edhe greke ku ka studiuar... Të më falni që u tregova pak proliks edhe për rastin e z. Aristotel Spiro, por desha të nënvizoj se z. Tufa nuk ka ditur të mësojë nga shembulli i intelektualëve të vërtetë. Ai di vetëm t’i vjedhë ata si në rastin e z. Aristotel Spiro...

Por të kthehem te Rami Saari. Nga ai marr më 7 qershor të 2017 këtë email:

“On 7 jul 2017, at 22:31...

I dashur Ilir!

...

Dua të të lutem për një gjë. Meqenëse ndodheni në Shqipëri, a mund të më gjesh adresën elektronike të Luljeta Lleshanakut. Dikur e kisha, por e kam humbur dhe më duhet t'i shkruaj. Arsyeja është se kam përkthyer poezinë e bukur të saj "Ata nxitojnë të vdesin" në hebraisht, por nuk mund të botoj perkthimin 1. pa autorizimin e poetes dhe 2. pa ditur se në cilin libër e ka nxjerrë këtë poezi dhe kur është botuar ky libër.

Te falenderoj përsëri dhe të uroj gjithë të mirat.

Rami"

Meqenëse mësova se poetja Luljeta Lleshanaku punonte si vartëse e z.Tufa në Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, kërkova nga miq të përbashkët numrin e telefonit të z. Tufa që pastaj të kërkoja ndihmën e tij për të më lidhur me z. Lleshanaku. Z. Tufa u tregua shumë i gatshëm kur komunikova në telefon me të dhe lidhja e poetes sonë të talentuar me përkthyesin e madh u krye. Pra Rami Saari, përkthyesi i madh, që me lejen që kërkonte paraprakisht me shkrim nga autorja Luljeta Lleshanaku (fatlume në atë rast) veç shembullit e kontributit intelektual që jepte me shkrimin e tij në mbrojtje të kauzës së drejtë të Kosovës, z. Tufa duhet të kishte nxjerrë mësim nga korrektesa e intelektualit të shquar izraelit. Vetëm për të shpjeguar shpërfilljen nga ana e z. Tufa të këtyre mesazheve rastësore që na ofron ndonjëherë jeta u zgjata u zgjata kaq hollësisht në përgjigje të kureshtjes suaj.

– Me këtë që sapo na treguat ne po kuptojmë se mes jush dhe misionit që kryen Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe drejtorit të saj z. Agron Tufa nuk ka asgjë armiqësore. Ai pretendon se redaksia e gazetës sonë “Dita” ju ka kërkuar me qiri në dorë për t’ju kundërvënë një “antikomunisti”? Mund t’i përgjigjeni kësaj akuze dhe të na thoni shkurtimisht me dy fjalë cili është qëndrimi juaj ndaj misionit të ISKPK –së dhe LANC-it?

– Po. Përsa i përket punës e misionit të Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit unë nuk kam asgjë armiqësore... Megjithëse në rrethin tim të sotëm familjar (madje të ngushtë, siç është bashkëshortja ime) si edhe shumë të afërt e shokë të mi i përkasin asaj shtrese, jam krejt indiferent sepse vetë nuk i përkas asaj shtrese... Ndërsa për qëndrimin tim ndaj historisë së LANC, rolit të PKSH në atë kohë jam shprehur edhe në faqet e gazetës tuaj Dita (19 gusht 2016), me shkrimin “Historianët si kuzhinierët pa kapele” (<http://www.gazetadita.al/historianet-si-kuzhinieret-pa-kapele/?fbclid=IeAR1VlhDhUQq2pYqagSLvlx7aQZCU0kdh0DIRFrzgOiEfZkXNALjxCgëAqis>)

Në shkrimin tim që më përfshiu modestisht edhe mua (dhe që ishte ndër të paktët që në debatin që provokoi i ndjeri gazetari juaj Andrea Stefani, i jepja pjesërisht të drejtë) synoja që të jepja opinionin tim që në thelb ishte se: çështjet e historisë nuk debatohet me zë të “trashë” e me dogmatizëm, por vetëm nga historianë kompetentë, pa pasione e emocione, si edhe pa reminishenca të së kaluarës komuniste...

Ndërsa sa për atë “qiriun” që thotë z. Tufa se më gjetët ju të gazetës “Dita” për t’iu kundërvënë “intelektualit antikomunist”, si kundërprovë përsëri mund t’ju sjell një bashkëpunim timin me gazetën tuaj qysh më 3 tetor të 2016-s. Madje për të njëjtën temë për të cilën po flasim, edhe në atë shkrim “Ambientimin me vjedhjen brenda në Kuvend”:

(<http://www.gazetadita.al/ambjentimi-me-vjedhjen-brenda-ne-kuvend/>)

..Se që të jemi të qartë: Edhe problemi mendoj se nuk shtrohet vetëm për çështjen e doktoraturës së Agron Tufës, se po të ishte vetëm ajo, skandali do të ishte shumë i rëndomtë. Mendoj se problemi qëndron tek ambientimi me plagjiarizmin, me këtë kancer të universiteteve shqiptare. Ambientimi me këtë “prostitucion intelektual” të

shtrirë në në çdo cep të mjediseve tona akademike, është, fillim – mbarim, ajo që duhet goditur...

Po ta shohim të veçuar skandalin Tufa, do të gabonim shumë. Bash për këtë, në denoncimet e mia publike jam munduar të shmang episodet groteske që përfshijnë këtë skandal... Situata në universitet tona është alarmante... Agron Tufa me qëndrimet e tij publike duke luajtur i dyzuar “trimin dhe viktimën” është pak të thuash qesharak. Cdo ditë që pasoi publikimin e skandalit të tij të “doktoraturës” e ka kthyer në një figurë tragjikomike, madje për pozitën shtetërore që ka, me ato që deklaroi publikisht, edhe të rrezikshëm. Për këtë mendoj se duhet të jemi të kujdesshëm e të mos harrojmë një gjë dhe nuk duhet të mërzhitemi e të lodhemi duke i rënë kësaj kambane alarmi: Situata në universitetet tona është thellësisht e rëndë. Mafia akademike është ulur e drejton këmbëkryq! Këtë nuk e them vetëm unë që jam larg tyre, por të gjithë studentët, profesorët e intelektualët e aftë e të ndershëm që ka ende në auditoret e universiteteve tona. Pra gjendja është pak të thuash tragjike dhe nuk ka aspak vend për të nënqeshur as ironikisht. Siç ua theksova edhe më lart, në provat që denoncojnë plagjiarizmin e Agron Tufës më 2015 unë jam munduar të shmang sa të mund veprimet qesharake dhe incidentet me nota të larta komike që shoqërojnë me bollëk skandalin e Agron Tufës.

– Z. Mborja! Mund të na thoni vetëm një rast të tillë komik?

– Vetë fakti që, në shkurt të vitit 2008 Agron Tufës iu dha grada doktor pa paraqitur fare formalisht ndonjë punim, qoftë edhe plagjiaturë (!) dhe që pastaj e detyroi atë të mbledhë andej – këndej tekste e artikuj të cilat t’i paraqiste kinse si punim doktore 7 vjet më vonë, kur ia kërkuan materialin e doktoraturës autoritetet e UT-së, është një komedi groteske më vete. Megjithatë, mbase për ta ç’dramatizuar sa të mundemi situatën po ju sjell vetëm një rast: Në kumtesën “Fan Noli dhe shqipërimi si antinomi terminologjike”, që Dr: Aristotel Spiro mbajti në në Universitetin e Korçës më 2012, në fund të çdo faqeje kishte të shënuar burimet e referencave. Në botimin në internet të Buletinit të Konferencës, aty ku e përvetësoi me copi – paste Agron Tufa (mbase për arsye se ka ndryshuar faqosja) ato, dmth referencat, mungojnë. Kështu, duke kujtuar se me copi – paste ka vjedhur vetëm Aristotel Spiron, “Doktor” Tufa ka abuzuar padashje edhe me të tjerë studiues. Sigurisht, jam i sigurtë se ai nuk e di ende se kë e sa “ka bërë kurban” me

plagjiaturën e tij. Shqip: Ky rast që ju solla dëshmon se ai nuk di ende se kë dhe sa të tjerë ka vjedhur... Prandaj gjer më sot nuk isha ndalur të tregoj banalitete të tilla komike, se situata nuk le vend për të qenë aspak i tillë. E përsëris: Situata në arsimin universitar është tragjike!.. Për Agron Tufën, po: Është tragjikomike!..

– Zoti Tufa publikoi par dy ditësh një mesazh anonim që kishte marrë avokati i tij ku e kërcënonin me vdekje. C’mund të na thoni? Nuk ju duket e rëndë kjo?

– Besoj se një përgjigje shteruese për arsyet e qëndrimit të përsëritur, të sforcuar e qesharak të vetëviktimizimit nga ana z. Tufa, e dha z. Fatos Tarifa në shkrimin e botuar në gazetën tuaj “Dita”. Për mua do të mjaftonte vetëm titulli “Mjaft më me këmbana të rreme alarmi!” për të shpjeguar gjithçka ka ndodhur.

Nga ana ime, në lidhje me këtë rast, do të shtoja se gjithçka tha Agron Tufa me pseudo “kërcënimin” e tij e të avokatit Cakrani, në mos për përfitimin e ndonjë strehimi siç po përflitet, besoj se e bën t’i shpëtojë prokurorisë për hajdutllëqet e panumërta që i dolën këto ditë... Llogaritni: (veç pagës) ka futur në xhep + 200 000 lekë të vjetra në muaj që nga 2008-a. Bëjeni pak hesapin sa ka vjedhur vetëm me “doktoraturën” e famshme për 11 (vjet) x 12 (muaj) x 200 000 (lekë) = ?..

Ku ishin Tufa e avokati, pse nuk u “kërcënuan” kohë më parë nga “ata që shkruan mesazhin e fshehtë”?.. Pse tani na u tremb “trimi”, apo se tani i nxorëm provat e pakundërshtueshme për vjedhje të “doktoraturës”...

U tremb “trimi”, megjithëse e dinte shumë mirë që në fejttonin e parë, që, kurrë nuk e çova ndërmend të ve në punë prokurorinë për një “lepurush” si ai. Edhe sot që flasim nuk kam atë dëshirë e nuk ndjehem mirë të shoh njeri pas hekurave, as edhe një hajdut ordiner si “lepurushi”... Pale të bëhesha dorë vetë.

Por “intelektuali” viktimë s’pushon së publikuari palavi ku të mundë. Që në publikimin e parë më 3 shtator, s’më la aspak kohë të më brente ndërgjegjja se mes gjithë tufës mafioze që ka mbërthyer prej fyti universitetin tone, mos e kisha rënduar më shumë se ç’duhej Agron Tufën ... Ia behu në ËhatsApp-in tim sms-ja e ndyrë me shpifje dhe gëlba nga “Doktor” Agron Tufa?!

“Intelektuali” edhe dje (tek i drejtohej dikujt me emrin Genci Tufa) shkruante te statusi i tij poshtë shkrimit të një farë Behar Gjoka (Kush është në gjendje t’i mbajë të përzierat mund ta lexojë deri në fund:

<https://observerkult.com/lincimi-i-frikshem-i-agron-tufes/>) në FB këmbul përsëri se është ai viktimë e plagjiaturës?! Harron se kur e ka hequr “rektorati” e ka pranuar njëherë vjedhjen. Por jo. Vini re gjuhën e “intelektualit Tufa” që kujton se po të vetëquhesh i tillë dhe kur bie fjala për Shqipërinë, ta shkruash “Shqypni”, duke shpërfillur drejtshkrimin, je “intelektual antikomunist”, paçka se fjala “shkërdh...” është e denjë vetëm për shoqërinë e burgaxhinjve ku padrejtësisht Agron Tufa i mungon fizikisht prej kohësh. Të paktën që nga 2008-a... Lexojeni më mirë vetë gjithçka shkruan, por mos harroni t’i vini një pullë të kuqe për të shmangur fëmijët nga palavitë pornografike që shkruan “intelektuali” ynë – Agron Tufa: “Genci Tufa une kam mbrojtur doktorraten me 18 shkurt 2008, me Komision, me firma, me procesverbale perkatese dhe kopje te firmosura te punimit qe gjenden ne dosjen time ne arkiv. Që nga ai moment, une jam i lare. Nuk e kam mbrojtur online, ne kataloge elektronikë, por fizikisht, me protokoll, ne Departament. Ne 2015 rshte kerkuar versioni elektronik, i cili eshte ne perputhje me versionin print te 2008. Une nuk marr me persiper asgje çfare ndodh pas dites qe e kam mbrojtur me 98 pike ne shkurt 2008.

Pastaj,vse si mund te plagjiohet nje tekst i shkruar e botuar me 2012, kete une nuk e kap as me nendje, as me imagjinate.

Dosja origjinale eshte aty, qe me 2008 dhe 7 anetaret e Jurise qe kane firmosur, kane udhehequr e kane bere oponence, jane fale Zotit te gjithe gjalle. Une nuk kam pune me ata qe shkerdhehen kibernetikisht!”

E shikoni? Ai ia hap vetë “gropën” vetes se nuk diti për asnjë çast ta qepë atë gojë e të heshtë...

– Në intervistën që dha në TV FAX NEWS bashkë me avokatin e tij z. Kujtim Cakrani në lidhje me “kërcënimin për vrasje” që ka marrë z. Tufa tha se “kërcënimet” e gjithçka bëhet së fundmi për të, bëhet për ta goditur atë për shkak të misionit dhe detyrës që kryen në lidhje me denoncimet e krimeve të komunizmit dhe qëndrimin e tij ndaj historisë së LANCit.. Në intervistë, as zoti Tufa as drejtuesi i intervistës nuk e përmendi çështjen e “doktoraturës” që e përfshin drejtorin e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në një skandal të jashtëzakonshëm. Madje z. Tufa la të kuptohej se edhe ky skandal është një shpifje që bëhet në atë kuadër. Keni ndonjë koment për këtë?

– Para se të përgjigjem për intervistën tek “FAX NEWS”, mbase do t’ju befasoj, por po ju them se për një gjë pajtohesh plotësisht me Agron Tufën: vetëm kur shtroi pyetjen: “Pse heshtin institucionet?”.

Agron Tufa kishte shumë të drejtë kur foli për heshtjen dhe mes heshtjeve përmendi edhe heshtjen e pashpjegueshme të Prokurorisë. Denoncimi publik i rastit të plagjiarizmit të Agron Tufës dëshmoi përmasat reale të gjendjes tragjike në të cilën ka rënë arsimit kombëtar. Në disa shkrime të njëpasnjëshme dhe në intervistën e Dr. Aristotel Spiros dhënë gazetës “Dita” u dhanë prova të pakundërshtueshme të plagjiarizmit akademik të Agron Tufës. Por dëshmia më e madhe ishte heshtja që pasoi këtë denoncim. Heshtje... Heshtje... Heshtje... Vetëm heshtje... Një heshtje fajtorësh... Një heshtje mëkatarësh... Heshtje nga bota akademike... Nuk reagoi Rektorati i UT, as dekanati i Fakultetit Filologjik, as Departamenti i Letërsisë i atij fakulteti. Asnjë pedagog i përmendur si i implikuar nuk reagoi. Asnjë pedagog. Përveç Behar Gjokës që përmenda më lart...

Heshtje nga mekanizmat e pushtetit gjyqësor! Në një shtet normal akuza publike për plagjiarizëm drejtuar një personi i cili mban një post të rëndësishëm me sensibilitet të lartë shoqëror (Drejtor i Institutit të Kërkimit të Krimeve të Komunizmit) prokuroria do të urdhëronte menjëherë krijimin e dosjes gjyqësore. Por çfarë vumë re në këtë rast? Asnjë reagim (!). Asnjë lëvizje (!). Sistemi ynë i drejtësisë, i ngërthyer në ngërçin e “katharsisit” të imponuar (Vetingut), në apati të plotë, reagoi thjesht me heshtje. Një heshtje aspak dinjitoze! Heshtje nga ana e qeverisë! Hesht ministrja e arsimit! Hesht kryeministri! Por tani e vërteta duket shumë qartë. Gënjeshttrat morën

fund! Mbreti është lakuriq. Reforma e arsimit të lartë që gjoja keni bërë doli thjesht një BLOF. Rezultati? Pedagogë analfabetë me grada e tituj doktorë e profesorë (me shumë shumë pak përjashtime), por që nuk dinë të nyjëtojnë dy fjalë të sakta, përveçse kur kopjojnë. Përveçse kur ushtrojnë plagjiarizmin. Plagjiarizmi, kanceri i universiteteve shqiptare! Plagjiarizmi, “prostitucioni intelektual” i mjediseve akademike, i organizuar dhe i toleruar nga personat që kanë zënë vendet drejtuese nëpër departamente, dekanate, rektorate. Të gjithë e dinë ç’po ndodh, por asnjë nuk tregon! “Omertaja e Kamorës”! (“Omertaja” – Kodi i pashkruar i “nderit” të Mafies së Kamorës që ekzekutonte me vrasje ata që thyenin heshtjen për veprimet e kriminale të tyre në Siçilinë e viteve ’70...) A e mbani mend festën që keni bërë për reformën e arsimit të lartë, zoti kryeministër? A ju kujtohet se çfarë na premtuat? Shikoni tani se ku e keni arsimin! Tani keni një lukuni “analfabetësh modernë”, një mafie akademike që çon drejt varrit arsimin kombëtar. Nuk keni më kohë, nuk keni justifikime. Duhet tani të veproni. Përndryshe asnjë fjalë e bukur nuk do t’ju shfajësojë.

C’të thuash më shumë për këtë shoqëri që çuditërisht vetëm hesht?.. Po ju zonja Ministre! Pse nuk përgjigjeni në lidhje me skandalet në UT te Filologjiku? Ju lutemi, përgjigjuni! Do t’ju falënderonim qoftë edhe me një përgjigje “Mos më çani kokën më për këtë problem!”, por përgjigjuni ju lutem, ta kuptojmë që jeni gjallë!..”...

Vijon nesër

Source: <http://www.gazetadita.al/ilir-mborja-agron-midis-luanit-dhe-lepurushit-zgjidh-te-dytin/>